



**RRJETET SOCIALE:
UDHËZUES I
DETAJUAR PËR
PRINDËR,
KUJDESTARË
DHE
ARSIMTARË**



UDHËZUES I DETAJUAR PËR
PRINDËR, KUJDESTARË DHE
EDUKATORË/MËSIMDHËNËS
PËR RRJETET SOCIALE

Autorët

Teuta Zymeri

Gresa Statovci

Nertila Ahmeti

Qendra për studime të avancuara FIT

Mbështetur nga:

Save the Children

Programi i implementimit dhe programi për zhvillim dhe kualitet

Lektor:

Envinion

Dizajni, faqosja dhe shtypja:

Envinion

Botuar nga:

Save the Children

Gazmend Zajmi, nr. 01

10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 23 26 91

Faks: +381 (0) 38 23 26 93

Scik@savethechildren.org

<http://Kosovo.savethechildren.net>

Copyright © Tetor 2015 “Save the Children”

Ky publikim është i mbrojtur nga e drejta e autorit. Ai mund të riprodhohet me çdo metodë, pa pagesë apo leje paraprake për qëllime mësimore, por jo për rishitje. Për përdorim në çfarëdo rrethane tjetër, leje paraprake me shkrim duhet të merret nga autori dhe botuesi. Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë mendimet e Save the Children. Si pjesë e sistemit të llogaridhënies së Save the Children: Nëse keni ndonjë ankesë, reagim apo pyetje, ju lutem t’i ndani ato me ne në scik@savethechildren.org.



Qendra për studime të avancuara FIT

E-mail: info@fit-ks.org

www.fit-ks.org



Save the Children

PËRMBAJTJA

HYRJA.....	4
RRJETET SOCIALE	5
FACEBOOK.....	7
Rreziqet potenciale në Facebook	7
Rregullat e privatësisë dhe veglat	8
Mesazhet në Facebook	9
Bllokimi i personave	10
Etiketimi i fotografive	12
Postimi dhe privatizimi i fotografive/postimeve	13
Lokacioni se ku gjendeni (anglisht Check-in)	14
Fëmijët dhe Facebook	15
INSTAGRAM.....	16
Çka është Instagrami.....	16
Profili i Instagramit.....	17
Opsionet e privatësisë	18
Postimi në Instagram.....	19
Eksplorimi i fotografive	20
Hashtag - Thurje	21
Metodat e sigurisë në Instagram	21
Bllokimi i përdoruesve të Instagramit.....	23
Fëmijët dhe Instagram	24
SNAPCHAT.....	25
SnapKidz.....	25
Postimi në Snapchat	25
Opsionet e privatësisë	26
Rreziqet e Snapchat.....	27
YOUTUBE.....	28
Postimi i videove në YouTube.....	31
KONKLUZIONE	32

HYRJA

Qendra për studime të avancuara FIT (Qendra FIT) në partneritet me organizatën Save the Children në Kosovë ka ndërmarrë një nismë për të zhvilluar një udhëzues të detajuar për prindër, kujdestarë dhe edukatorë/mësimdhënës lidhur me përdorimin e rrjeteve sociale nga fëmijët. Ky Udhëzues është realizuar në kuadër të projektit “Promovimi i përdorimit të internetit në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt në mesin e fëmijëve”.

Publikimi i këtij Udhëzuesi është kurorëzim i një pune të gjatë të zhvilluar në konsultime të vazhdueshme me prindër, kujdestarë dhe edukatorë/ mësimdhënës. Kemi kënaqësinë që nëpërmjet këtij dokumenti të ju ofrojmë këshilla dhe udhëzime lidhur me rrjetet sociale dhe sjelljen e fëmijëve në rrjetet sociale. Ky material është i pari i këtij lloji në Kosovë dhe qëllimi kryesor i tij është t’u ndihmojë prindërve dhe edukatorëve/ mësimdhënësve për të kuptuar sjelljen e fëmijëve në rrjetet sociale dhe nevojën e madhe që të rritet vetëdijësimi për mbrojtjen e fëmijëve në internet.

Udhëzuesi merr për bazë zhvillimet e shpejta të teknologjisë, siç janë: integrimi i rrjeteve sociale në telefona të mençur, përhapja e qasjes në internet pa tela (wireless) dhe çështjet që kanë të bëjnë me sjelljet e fëmijëve në ditët e sotme. Për më shumë, diskuton edhe çështjet që kanë të

bëjnë me aktivitetet e fëmijëve në rrjetet sociale, siç janë hapja e profileve, bisedat në ‘chat’, shkarkimi i materialeve, postimi, publikimi i të dhënave personale, rregullimi i privatësisë dhe bllokimi i personave të padëshiruar. Ky Udhëzues është hartuar për të ofruar informata dhe këshilla për prindër, kujdestarë të fëmijëve dhe edukatorë/ mësimdhënës lidhur me sjelljen e fëmijëve në rrjetet sociale dhe ofron këshilla praktike të ilustruara figurativisht për të zgjidhur probleme në situata të ndryshme gjatë përdorimit të rrjeteve sociale.

Objektivat kryesorë të këtij Udhëzuesi janë: informimi i prindërve, kujdestarëve të fëmijëve dhe edukatorëve/mësimdhënësve me mënyrën e përdorimit të rrjeteve sociale nga fëmijët; me rreziqet potenciale që fëmijët e tyre hasin gjatë përdorimit të rrjeteve sociale; dhe me këshilla praktike për t’i mbajtur fëmijët më të sigurt gjatë përdorimit të rrjeteve sociale.

Inkurajohen prindërit, edukatorët/mësimdhënësit dhe të rriturit e tjerë që përkujdesen për fëmijë, të përdorin këtë Udhëzues për mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet potenciale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Në të njëjtën kohë, Udhëzuesi ofron këshilla praktike për përdorim më të sigurt të rrjeteve sociale.

RRJETET SOCIALE

Sot rrjetet sociale në internet janë mënyra më e përhapur e komunikimit nga të rriturit dhe fëmijët. Në bazë të hulumtimit “Siguria e fëmijëve në Internet”, të realizuar nga Qendra FIT në Qershor të vitit 2014, rrjetet sociale më të popullarizuara të fëmijët në Kosovë janë: Facebook, Youtube, Instagram etj.¹ Fëmijët përdorin këto rrjete kryesisht për të komunikuar dhe për t’u informuar për tema të ndryshme. Në rrjete sociale ata kanë mundësi edhe të postojnë fotografi, video, të luajnë lojëra, dhe të bëjnë shumë aktivitete të tjera.²

Jeta virtuale sot është bërë pjesë e të rinjve pas së cilës ata shpeshherë janë shumë të apasionuar dhe për çka shpeshherë shpenzojnë shumë kohë. Kalimi i kohës së gjatë në rrjetet sociale ka efekte pozitive dhe negative. Interneti ka potencial të madh si një mjet për zhvillimin dhe fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve, si dhe për t’i ndihmuar ata në gjetjen e gjërave për nevojat e tyre. Megjithatë, fëmijët gjatë qëndrimit në internet e posaçërisht në rrjete sociale, janë të ekspozuar ndaj shumë

rreziqeve për të cilat shpesh nuk janë në dijeni. Prandaj, për të qenë në gjendje që prindërit, kujdestarët dhe edukatorët/mësimdhënësit të monitorojnë fëmijët dhe sjelljet e tyre në internet, ata duhet të dijnë se si përdoren rrjetet sociale nga fëmijët, dhe të mësojnë disa rregulla të privatësisë në mënyrë që të mbrojnë fëmijët e tyre kur ata janë online.

ÇFARË JANË RRJETET SOCIALE?

Rrjetet sociale janë uebfaqe dhe aplikacione të cilat mundësojnë komunikimin virtual mes njerëzve në mbarë botën. Për të pasur një llogari në rrjete sociale kërkohen disa të dhëna personale si: emri, mbiemri, mosha, e-mail, fotografia personale, adresa, apo numri i telefonit. Në shumicën e rrjeteve sociale mosha e lejuar për hapje të llogarisë duhet të jetë mbi 13 vjeç. Mirëpo, këtë kriter shumë fëmijë nuk e zbatojnë. Shumica e fëmijëve në Kosovë gënjëjnë për moshën e tyre në mënyrë që të kenë mundësi të hapin llogari.

1 Besianë Musmurati, Teuta Zymeri, *Siguria e Fëmijëve në Internet*, Save the Children, Prishtinë, 2014, fq. 21

2 Public Legal Education & Information Center of New Brunswick, *Child Internet Safety*, New Brunswick, 2015, fq. 4

ÇFARË BËJNË FËMIJËT NË RRJETE SOCIALE?

Sipas hulumtimit “Siguria e fëmijëve në Internet” , aktivitetet më të shpeshta në internet nga fëmijët e Kosovës përfshijnë bisedat mes tyre në rrjetet sociale (74.2%), dëgjimi i muzikës në Youtube (58.9%), dhe video lojërat (45.8%). Siç vërehet nga shpeshësia e përdorimit të rrjeteve sociale nga fëmijët në Kosovë, ato janë disa prej mekanizmave më argëtues³. Megjithatë nëse nuk kontrollohen mirë mund të shfaqen shumë rreziqe për të cilat do të ju njoftojmë në vijim.

SI TË MONITORONI FËMIJËN TUAJ NË RRJETE SOCIALE?⁴

Informohuni. Gjëja e parë që duhet të bëni është të jeni mirë të informuar rreth rrjeteve sociale. Tashmë e dini se për çfarë përdoren ato rrjete sociale, prandaj gjëja tjetër që duhet të mësoni është se si të përdorni këto rrjete.

Bisedoni me fëmijën tuaj se çfarë bëjnë në Internet. Ju duhet t’i pyesni fëmijët se pse shpenzojnë kohë në rrjete sociale. Kërkoni që t’ua

tregojnë juve profilin e tyre të Facebook-ut apo rrjeteve tjera sociale, fotografitë që i postojnë, miqtë që i kanë në këto rrjete sociale, dhe gjërat tjera që ata postojnë dhe shpërndajnë në internet. Kështu ju keni mundësinë t’i tregoni fëmijës se çfarë është e përshtatshme për të postuar.

Hapni llogari në rrjetet sociale më të përdorura. Ndoshta mënyra më e mirë për të qenë më afër fëmijës në rrjete sociale është të hapni një llogari tuajën në rrjete sociale që fëmija juaj përdorë më shumë si psh: Facebook, Instagram dhe kështu e shihni se çfarë sjellin këto rrjete si dhe të kontrolloni postimet e fëmijës suaj.

Pyesni fëmijën tuaj se si të përdorni rrjetet sociale. Tashmë është e ditur se fëmijët kanë shumë njohuri për rrjete sociale dhe shpesh ua kalojnë prindërve me këto njohuri. Prandaj ju duhet të merrni njohuri nga fëmijët se si mund të postoni, shpërndani fotografi dhe video por edhe të rregulloni parametrat e privatësisë. Kjo mund të jetë dhe një arsye më shumë për t’i monitoruar fëmijët pasi që shumë fëmijë nuk i kushtojnë dhe aq rëndësi rregullave të privatësisë, të cilat janë shumë të rëndësishme për t’u mbrojtur nga keqbehësit.

3 Besianë Musmurati, Teuta Zymeri, *Siguria e Fëmijëve në Internet*, Save the Children, Prishtinë, 2014, fq.21

4 McAfee Inc., *A Parent’s Guide to Social Networking Sites*, Santa Clara CA, 2009, fq. 8, Web

FACEBOOK

Facebook është rrjeti social më atraktiv i përdorur nga të rinjtë Kosovarë. Në mbarë botën, Facebook në fund të qershorit 2015 kishte 1.49 miliard përdorues aktivë dhe numri i përdoruesve vazhdon të rritet çdo ditë⁵. Qendra FIT në vitin 2014 ka bërë një hulumtim me fëmijët e shtatë qyteteve më të mëdha të Kosovës dhe ka gjetur se 84% e fëmijëve kanë llogari të tyre aktive në Facebook ose Twitter, prej të cilëve 32% kanë mbi 400 miq. Në mesin e miliona përdoruesve të Facebookut në botë ka edhe shumë keqpërës të cilët kanë mundësi të shumta për keqpërdorim të të dhënave personale të fëmijëve, të ofrojnë të dhëna të rreme për vete, të shoqërohen dhe takohen me të rinj - takime të cilat shpeshherë sjellin rreziqe dhe pasoja të ndryshme.

Rrjeti Facebook ofron mundësi për komunikim mes shokëve, postime të ideve, fotografive, videove, dhe materialeve të tjera të ngjashme. Është një rrjet social shumë i sofistikuar i cili çdo herë e më shpesh vjen me ndryshime në pamje, parametra të privatësisë, shumë mundësi të reja, por edhe me rreziqe të shumta. Prandaj, nga prindërit, kujdestarët dhe edukatorët/mësimdhënësit kërkohet të jenë të përditësuar

me njohuri, posaçërisht me njohuri që lidhen me parametrat e privatësisë së Facebook.

RREZIQET POTENCIALE NË FACEBOOK

Si rrjeti social më i përdorur nga fëmijët, Facebook paraqet rreziqe nga më të ndryshmet. Disa nga rreziqet potenciale që fëmijët i hasin më shpesh gjatë përdorimit të Facebook janë paraqitur në vijim:

- 1** Sabërdhuna apo dhuna online: fëmijët shpërndajnë fotografi, mesazhe dhe postime poshtëruese, tallen apo kërcënojnë fëmijë të tjerë në Facebook për motive të shumta.
- 2** Krijimi i profileve të rreme: fëmijëve u hapen profile me informatat e tyre personale në emër të tyre dhe keqpërdoren në forma të ndryshme.
- 3** Takimi me njerëz të panjohur: fëmijët shtojnë si shokë në Facebook njerëz të panjohur dhe shoqërimi me ta mund të paraqesë rrezik në dimensione të ndryshme.
- 4** Shpërndarja e fotografive të papërshtatshme: fëmijët shpërndajnë fotografi personale apo të shokëve/shoqeve, të cilat janë të papërshtatshme, dhe që mund të dëmtojnë imazhin e tyre. Për shembull fotografi


⁵ Company Info, Facebook Newsroom, Menlo Park CA, 2015, Web

me veshje provokative të cilat pastaj qasen nga një audiencë më e gjerë dhe kanë mundësi shumë më të madhe keqpërdorimi.

5 Editimi dhe keqpërdorimi i fotografive: fotografitë e fëmijëve mund të editohen me anë të programeve të ndryshme; psh. fytyra e një vajze mund të vendoset në trupin e një vajze tjetër e cila ka veshje të papërshtatshme, dhe të shpërndahet në rrjete sociale.

RREGULLAT E PRIVATËSISË DHE VEGLAT

Facebook ka modifikuar dhe thjeshtësuar qasjen në rregullat e privatësisë duke lehtësuar kështu kontrollin e privatësisë. Kur qaseni në Facebook, këto shkurtesa të privatësisë mund t'i gjeni në anën e djathtë lart tek faqja kryesore si në figurën më poshtë.



Këtu mund të rregulloni bazat e privatësisë suaj: kush mund të shohë profilin tuaj, kush mund të ju kontaktojë, kush mund të ju dërgojë kërkesa për shoqërim dhe mund të bllokoni persona të padëshiruar.

1. KUSH MUND T'I SHIKOJË GJËRAT E MIA?

Në këtë pjesë të sigurisë në Facebook ju mund të rregulloni se kush mund të shohë postimet tuaja në kohështrirjen tuaj, pastaj kush mund të postojë në kohështrirjen tuaj, dhe kush mund të etiketojë në fotografi të ndryshme që ju keni postuar.

Nëse vendosni që **të gjithë** të mund të postojnë në kohështrirjen tuaj atëherë edhe personat të cilët nuk i keni shokë në Facebook kanë mundësi të postojnë. Sugjerohet që të zgjedhni vetëm **shokët** tuaj të ju lejohet të postojnë në kohështrirjen tuaj.


Për t'i parë gjërat që keni postuar si dhe fotografitë në të cilat jeni të etiketuar klikoni te "Përdoreni protokollin e veprimtarive".

Facebook ua jep mundësinë të shihni kohështrirjen tuaj në sy të të tjerëve. Vetëm klikoni te "shiko sikur" dhe ju hapet kohështrirja juaj duke treguar se çfarë postimesh mund të shohin personat tjerë për ju.



1.2 KUSH MUND TË MË KONTAKTOJË MUA?

Tek mesazhet janë dy zgjedhje :“Filtrimi Bazë” -çdokush mund të ju dërgojë mesazhe, dhe “Filtrim i rreptë” - shumica e mesazheve janë të shokëve tuaj, mirëpo edhe personat të cilët nuk i keni miq në Facebook mund të ju dërgojnë mesazhe të cilat nuk vijnë direkt në inbox por tek “mesazhe të tjera”. Kjo paraqet rrezik pasi që mund të vijnë mesazhe të papërshtatshme apo edhe kërcënuese nga persona të cilët nuk i keni shokë as në Facebook e as në jetën reale. Gjithmonë sugjeroni fëmijën tuaj të zgjedhë “Filtrim i rreptë” në mënyrë që personat e panjohur ta kenë më të vështirë të komunikojnë me fëmijën.



Në rast se nuk dëshironi që çdokush të ju dërgojë ftesë është më mirë të zgjidhni mundësinë shokët e shokëve, kështu që vetëm personat me të cilët keni miq të përbashkët mund të ju dërgojnë ftesë për shoqërim. Këtë mund ta bëni tek “Shkurtesat e Privatësisë” nëse klikoni tek “Kush mund të më

kontaktojë mua?"; "Kush mund të më dërgojë ftesa për shoqërim?" dhe pastaj zgjedhni opsionin që dëshironi.

1.3 SI MUND TË NDALOH DIKË QË MË BEZDIS MUA (BLOKIMI I PERSONAVE)?

Facebook jua jep mundësinë të bllokoni personat të cilët ju bezdisin. Që nga momenti kur e bllokoni një person, ai nuk do ta marrë asnjë njoftim që është bllokuar nga ju dhe nëse vendosë të ju kërkojë në Facebook nuk do të mundet të ju gjejë. Ju gjithashtu mund të bllokoni ftesa për ngjarje të ndryshme, programe të ndryshme, dhe faqe të ndryshme. Gjithmonë bisedoni me fëmijën tuaj rreth ngacmimeve në rrjete sociale. Kur fëmijët ndihen të ngacmuar ata mund ta bllokojnë atë person që të mos ketë më qasje në profilin e tyre mirëpo t'i ruajnë mesazhet dhe postimet e atij personi, në mënyrë që prindërit dhe mësimdhënësit të jenë në dijeni dhe të kenë fakte se çfarë ka ndodhur.



 **Kontrolli i privatësisë** 

 Kush mund t'i shikojë gjërat e mia?

 Kush mund të më kontaktojë mua?

 Si mund ta ndalojë dikë që më bezdisë mua?

Shiko më shumë rregullime ose vizito Bazat e Privatësisë

Për t'i kontrolluar fotografitë në të cilat jeni të etiketuar, ju duhet të klikoni te "Shiko më shumë rregullime" ose "Bazat e Privatësisë". Pasi të keni klikuar, ju hapet faqja me më shumë opsione ku pastaj keni mundësinë të zgjedhni "Kohështrirja dhe etiketimet".

 Të dhënat e përgjithshme

 Siguria

 Privatësia

 Kohështrirja dhe etiket...

 Bllokimet

 Gjuha

 Njoftime

 Celular

 Ndjekësit

 Programet

 Reklammat

 Pëgsesat

 Kulla e mbështetjes

 Videot

Rregullimet e kohështrirjes dhe të etiketimeve

Kush mund të shtojë gjëra në kohështrirjen time?	Kush mund të postojë në kohështrirjen tënde?	Shokët	Ndrysho
	Rishiko postimet ku të kanë etiketuar shokët para se ato të shfaqen në kohështrirjen tënde?	Kyçur	Ndrysho
Kush mund t'i shikojë gjërat në kohështrirjen time?	Bëni një shikim paraprak se si e shohin njerëzit tjerë kohështrirjen tuaj		Shiko si
	Kush mund t'i shikojë postimet në të cilat jeni etiketuar në kohështrirjen tuaj?	Shokët	Ndrysho
	Kush mund të shikojë se çka postojnë të tjerët në kohështrirjen tuaj?	Shokët e shokëve	Ndrysho
Si mund t'i menaxhoj etiketat që shtojnë njerëzit dhe sugjerimet për etiketime?	Rishiko etiketat që shtojnë njerëzit në postimet e tua para se etiketat të shfaqen në Facebook?	Shkyçur	Ndrysho
	When you're tagged in a post, who do you want to add to the audience if they aren't already in it?	Shokët	Ndrysho
	Kush mund t'i shikojë sugjerimet për etiketa kur ngarkohen foto që të ngjajnë ty?	Shokët	Ndrysho

ETIKETIMI I FOTOGRAFIVE

Ju mund të vendosni se kush mund t'i shohë fotografitë në të cilat jeni të etiketuar (anglisht Tag). Edhe këtu ekziston mundësia të zgjedhni që të gjithë t'i shohin fotografitë e etiketuara, shokët e shokëve, vetëm shokët tuaj apo vetëm ju. Nëse dëshironi që një fotografi ta ndani vetëm me një ose disa shokë në Facebook por nuk dëshironi ta shohin të gjithë shokët tuaj, mund të klikoni te "I përshtatur" dhe mund t'i vendosni në një listë ata persona.

Ju mund të etiketoheni në fotografi të ndryshme, andaj është shumë e rëndësishme të "Kyçni" postimet ku ju kanë etiketuar shokët. Gjithashtu, në postimet e juaja secili shok mund të etiketojë veten kështu duke u mundësuar shokëve të tij qasje në fotografitë tuaja. Megjithatë, ju mund të rishikoni etiketat dhe të vendosni se a doni t'i pranoni apo jo, duke klikuar te opsioni "kyçur" apo "shkyçur".

Kush mund t'i shikojë gjërat në kohështrirjen time?

Bëni një shikim paraprak se si e shohin njerëzit tjerë kohështrirjen tuaj

Shiko si

Kush mund t'i shikojë postimet në të cilat jeni etiketuar në kohështrirjen tuaj?

Mbyll

Shokët

Të gjithë

Shokët e shokëve

Shokët

Vetëm unë

I përshtatur

Më shumë mundësi

Si mund t'i menaxhoj etiketat që shtojnë njerëzit dhe sugjerimet për etiketime?

postojnë të tjerët në	Shokët e shokëve	Ndrysho
rëzitin në postimet e tuaja në Facebook?	Shkyçur	Ndrysho
who do you want to tag if they aren't already in it?	Shokët	Ndrysho

Si mund t'i menaxhoj etiketat që shtojnë njerëzit dhe sugjerimet për etiketime?

Rishiko etiketat që shtojnë njerëzit në postimet e tua para se etiketat të shfaqen në Facebook?	Shkyçur	Ndrysho
When you're tagged in a post, who do you want to add to the audience if they aren't already in it?	Shokët	Ndrysho
Who sees tag suggestions when photos that look like you are uploaded? (this is not yet available to you)	Unavailable	

POSTIMI DHE PRIVATIZIMI I FOTOGRAFIVE/POSTIMEVE

Facebook mundëson postimin e fotografive, videove, artikujve dhe shkrimeve të ndryshme. Të këto postime lejohet etiketimi i njerëzve, të shtoni atë çfarë po bëni ose ndjeni, dhe të tregoni lokacionin e saktë se ku gjendeni. Të gjitha këto postime mund të përcaktohen (rregullohen) në bazë të preferencës suaj. Për shembull ju mund t'i rregulloni postimet që t'i shihni vetëm ju, vetëm shokët tuaj, vetëm disa persona, apo t'i bëni publike ku mund t'i shohë çdokush.

Nëse dëshironi që t'i personalizoni publikimet tuaja, ju duhet të klikoni te një fotografi në ikonën në anën e poshtme të djathtë në opsionin:




Rregullimi i lokacionit

Rregullimi i postimeve që të shihen nga vetëm disa persona, shokët apo i gjithë publiku.

Pasi të keni zgjedhur opsionin "Public", ju mund të zgjedhni se cilën masë të privatësisë dëshironi.

Nëse dëshironi të lejoni vetëm disa persona të caktuar atëherë klikoni tek "Më shumë mundësi". Nëse dëshironi që vetëm shokët e ngushtë të ju shohin këtë postim, atëherë vetëm klikoni "Shokët e ngushtë". Nëse dëshironi të bllokoni disa persona që të mos kenë mundësi të shohin postimin tuaj, atëherë klikoni ikonën "I përshtatur".



Tek opsioni (ose nënmënyja) "Fshihe nga" shënoni emrat e personave që ju nuk dëshironi të shohin postimin tuaj dhe ata nuk do të kenë qasje në atë postim.



Këtu shkruani emrat e personave, apo listën e personave që ju nuk dëshironi të shohin postimin tuaj.

Mirëpo ky opsion nganjëherë përdoret nga fëmijët për t'ua bërë të pamundur prindërve të tyre të shohin postimet e tyre.

LOKACIONI SE KU GJENDENI (ANGLISHT CHECK-IN)

Facebook mundëson dhe postimin e lokacionit se ku gjendeni. Për shembull, ju mund të postoni një fotografi tek Pallati i Rinisë në Prishtinë dhe të tregoni saktë se ku gjendeni duke zgjedhur opsionin "check-in". Së pari, klikoni tek ikona në anën e poshtme të majtë.



Pastaj ju mund të shkruani emrin e vendit të saktë në adresë se ku gjendeni. Shpesh ndodh që Facebook do t'ju rekomandojë disa lokacione që gjenden afër vendit ku ndodheni në atë moment. Ju mund të zgjedhni ndonjërin nga këto opsione ose të shkruani emrin e një vendi që nuk është në listë.

Postimi tregon vendndodhjen. Çdokush që e sheh këtë postim është në dijeni se ku gjendeni dhe nëse ata klikojnë te "Pallati i Rinisë" në këtë rast, ata do ta kenë adresën e saktë të vendndodhjes tuaj.



FËMIJËT DHE FACEBOOK

- Publikimi i pakontrolluar i mesazheve, fotografive, dhe videove në Facebook mund të paraqesë rreziqe nga më të ndryshmet. Në rast se publikimet janë publike, atëherë çdo person mund të ketë qasje në ato publikime. Kur fëmijët postojnë në Facebook dhe zgjedhin opsionin "Public" ata humbin kontrollin në postimet e tyre. Gjithashtu, një problem tjetër në lidhje me monitorimin nga prindërit është zgjedhja e opsionit "I përshtatur" dhe bllokimi i prindërve/kujdestarëve. Andaj është shumë e rëndësishme të uleni me fëmijën tuaj dhe të shikoni llogarinë e tyre personale së bashku, të komentoni rreth postimeve që shokët/shoqet i bëjnë në Facebook në mënyrë që të rrisni vetëdijësimin tek fëmijët.
- Etiketimi në fotografi të papërshtatshme është një fenomen i përhapur tek fëmijët. Prandaj është shumë e rëndësishme të kyçni opsionin rishikimi i etiketimeve. Gjithashtu, inkurajoni fëmijët që të injorojnë "Mesazhet Tjera" ngaqë ato janë mesazhe nga çdokush e në shumicën e rasteve janë të papërshtatshme për fëmijë.
- Diçka tjetër që fëmijët përdorin shumë shpesh është opsioni "check in" i cili tregon lokacionin e vendndodhjes. Shumë shpesh fëmijët bëjnë "check in" kur dalin me familje apo shoqëri. Kjo mund të jetë një ndër rreziqet më të mëdha pasi që çdokush mund ta dijë se ku ndodhet fëmija juaj. Vendosja e lokacionit poashtu rrit rastin e vjedhjeve në shtëpi dhe banesa. Në qoftë se ju jeni diku me pushime me familjen tuaj dhe fëmija juaj vendos që përmes "check in" të tregojë se ku gjendeni, çdokush mund ta dijë që shtëpia juaj është vetëm.
- Edhe pse Facebook ka rregulla të privatësisë të cilat japin shumë opsione për sigurinë online, prapë janë disa gjëra të cilat gjithmonë mbesin publike si:
 - Fotografia e profilit - çdo person mund të klikojë dhe ta hapë fotografinë tuaj të cilën mundet edhe ta ruajë në pajisjet e tij;
 - Emri dhe Mbiemri - çdokush mund të ju gjejë në Facebook në bazë të emrit dhe mbiemrit;
 - Mesazhe të ju dërgojë çdokush - edhe personat të cilët nuk i keni në Facebook mund të ju dërgojnë mesazhe.

INSTAGRAM

ÇKA ËSHTË INSTAGRAMI?

Instagrami është një rrjet social shumë i popullarizuar që përdoret posaçërisht për shpërndarjen e fotografive dhe videove. Shpërndarja e fotografive dhe videove është shumë atraktive për fëmijët ngaqë mundëson rregullimin e fotografive me filterë të ndryshëm. Videot mund të jenë nga 3 deri në 12 sekonda. Tek Rregullat e Instagramit thuhet se "Ju duhet t'i keni të paktën 13 vjet që të përdorni Instagramin".

PROFILI I INSTAGRAMIT

Në faqen kryesore të profilit të Instagramit janë të përfshira këto veçori:

- Fotografia e profilit - çdo person mund të klikojë dhe ta hapë fotografinë tuaj të cilën mundet edhe ta ruajë në pajisjet e tij;
- Emri dhe Mbiemri - çdokush mund të ju gjej në Facebook në bazë të emrit dhe mbiemrit;
- Mesazhe të ju dërgojë çdokush - edhe personat të cilët nuk i keni në Facebook mund të ju dërgojnë mesazhe.




- Numri i postimeve që i keni bërë
- Ndjekësit/Followers
- Personat që ju i ndjekni/Following
- Emri dhe mbiemri
- Faqja e internetit
- Biografia
- Postimet tuaja me pëlqime dhe komente
- Forografitë ku jeni etiketuar
- Postimi i fotografive të reja

OPSIONET E PRIVATËSISË

Profili i Instagramit mund të mbahet privat ose publik. Nëse profili i Instagramit është privat, atëherë:

- Vetëm ndjekësit/followers mund t'i shohin postimet tuaja, pëlqimet dhe komentet
- Vetëm ndjekësit/followers mund të pëlqejnë, komentojnë apo shpërndajnë postimet tuaja
- Askush nuk mund të ju ndjekë/follow pa pëlqimin tuaj

Në mënyrë që të bëni profilin privat, zgjidhni butonin në anën e djathtë lart dhe pastaj tek opsioni 'Private Account' lëvizni butonin në anën e djathtë.




375
following

Nëse profili i Instagramit është publik, atëherë:

- Secili përdorues i Instagramit, pa marrë parasysh a e keni ndjekës (follower) apo jo, mund të shohë postimet tuaja.



- Secili përdorues mund të komentojë, pëlqejë dhë të shpërndajë postimet tuaja.
- Secili përdorues mund të ju ndjekë në Instagram pa pëlqimin tuaj.



← Përshkrimi i fotografisë

← Etiketimi i personave në fotografi

← Lokacioni

← Shpërndarja në rrjetet tjera sociale


← Postimi

POSTIMI NË INSTAGRAM

Në Instagram postohen vetëm fotografi ose video. Hapat të cilet ndërmerren gjatë postimit të fotografive janë:

- Selektimi i fotografisë/videos nga telefoni mobil
- Aplikimi i filterëve në Instagram
- Të shkruani ndonjë përshkrim të fotografisë
- Të etiketoni personat në fotografi
- Të tregoni lokacionin
- Të lidheni me rrjetet tjera sociale
 - Postimet e Instagramit mund të postohen në Facebook, Twitter, Tumblr, Flickr, Foursquare, etj.
- Të postoni fotografinë dhe ndjekësit tuaj të komentojnë, ta pëlqejnë, apo ta shpërndajnë.

Në momentin që postohet një fotografi, ndjekësit kanë mundësi ta pëlqejnë, komentojnë dhe të shpërndajnë atë postim.




- Instagrami mundëson vënien apo aplikimin e filterëve në fotografi me qëllim zbukurimin e postimeve. Këta filterë janë shumë atraktivë për fëmijët.


EKSPLORIMI I FOTOGRAFIVE

Karakteristikë e Instagramit është edhe faja Eksploruese e cila ka fotografi të ndryshme të personave që i kanë profilet publike. Një fotografi e cila merr pëlqime dhe komente hyn në faqen Eksploruese, në të cilën çdokush mund t'i shohë

këto fotografi. Gjithashtu, tek opsioni 'People' shfaqen mundësi për të ndjekur persona të tjerë në Instagram, dhe këto mundësi janë vetëm për persona që i kanë llogaritë e tyre publike.



HASHTAG – THURJE




Një tjetër karakteristikë e Instagramit është edhe opsioni Hashtag/Thurje. Me anë të këtij opsioni bëhet etiketimi i fotografive në bazë të përmbajtjes. Për shembull, nëse postohet një fotografi me përshkrimin “#shkolla”, atëherë të gjitha fotografitë publike që e kanë përshkrimin #shkolla do të dalin në faqen Eksploruese të Instagramit. Gjithashtu, nëse postohet edhe

lokacioni në fotografi, atëherë të gjitha postimet që janë bërë në të njëjtin vend do të jenë të publikuara në faqen Eksploruese.

METODAT E SIGURISË NË INSTAGRAM

- Fëmijët duhet të mbajnë gjithmonë profilin privat në mënyrë që mos të ketë mundësi çdo person të ketë qasje në profilin e tyre.
- Në rast se dëshironi të raportoni një postim të papërshtatshëm, ju mund ta bëni këtë në mënyrë anonime duke përcjellur hapat si vijon:




RAPORTIMI I NJË FOTOGRAFIE

Hapi i parë: Tek fotografia klikoni butonin me tri pika në anën e djathtë

Hapi i dytë: Klikoni "Report Inappropriate"

Hapi i tretë: Klikoni arsyen se pse e raportoni këtë postim


- Nuk më pëlqen kjo fotografi. (I don't like this photo)
- Kjo fotografi është spam. (This photo is spam or a scam)
- Kjo fotografi i vë njerëzit në rrezik. (This photo puts people at risk)
- Kjo fotografi nuk duhet të jetë në Instagram. (This photo shouldn't be on Instagram)



BLLOKIMI I PËRDORUESVE TË INSTAGRAMIT

Në rast se dëshironi të bllokoni një person konkret që të mos ketë qasje në profilin tuaj, atëherë klikoni butonin me tri pika në anën e djathtë,

“Block User” dhe “Yes, I’m sure”. Në momentin që ju bllokoni dikë, ai person nuk mund të ketë qasje në profilin tuaj, por mund të shohë komentet apo pëlqimet që i keni bërë një shoku të përbashkët në Instagram.



FËMIJËT DHE INSTAGRAM

Mbrojtja më e mirë e fëmijëve në Instagram është rritja e vetëdijësimit dhe privatizimi i llogarisë. Me anë të privatizimit të llogarisë fëmijët do të kenë mundësinë të vendosin se kush do t'i ndjekë në Instagram dhe kush do të ketë qasje në postimet e tyre. Në rast se profili është i hapur (publik), fotografitë do të mund të shihen nga çdokush dhe do të paraqiten tek "Eksplorimi i Fotografive" ku postimi i fëmijës suaj shihet nga të gjithë. Gjithashtu, me anë të përdorimit të opsionit hashtag/thurje, në rast se postimet janë publike, çdokush që është i interesuar për postimet rreth #shkolla, do të mund t'i shohë fotografitë me këtëthurje. Rreziku i paraqitur është mundësia e madhe e qasshmërisë dhe promovimit të profileve të Instagramit në rast se janë publike.

Për t'u siguruar që fëmija juaj është i sigurt në Instagram bisedoni me të rreth rregullave të privatësisë si:

- Të mendojnë për një fjalëkalim të sigurt, të cilin do të ishte e vështirë që të tjerët ta dinë;
- Ta ketë profilin privat kështu që të mund të parandalojë që fotografitë t'i shihen nga çdokush në Instagram pa marrë parasysh a e ndjekin apo jo;
- Vendosni bashkë me fëmijën tuaj se cila fotografi mund të jetë më e përshtatshme që të vendoset në profil, meqenësekjo foto mund të shihet nga çdokush edhe nëse e kanë profilin privat;
- Gjithmonë këshilloni fëmijët që të mos pranojnë ndjekës/followers të cilët nuk i njohin.
- Nëse fëmija juaj është nën moshën 13 vjeç dhe ka llogari personale në Instagram atëherë ju duhet t'i tregoni se si ta mbyllin Instagramin, njëkohësisht duke i informuar rreth rregullave të Instagramit.
- Për më shumë këshilla, informacione, dhe rregulla më të hollësishme rreth instagramit ju mund të klikoni në faqen: <https://help.instagram.com/299484113584685>

SNAPCHAT



Rrjeti social "Snapchat" për një kohë shumë të shkurtë është bërë shumë i popullarizuar sidomos nga të rinjtë. Snapchat është një aplikacion i cili mund të instalohet pa pagesë dhe të përdoret për shpërndarjen e fotografive, videove, vizatimeve, si dhe për të komunikuar me shokë/shoqe.

Një veçori e Snapchat është se të gjitha fotografitë dhe videot e shpërndara zhduken brenda 10 sekondave kështu duke u ofruar përdoruesve të komunikojnë lirshëm pa pasoja afatgjatë.



Fotografinë tuaj keni mundësi ta lejoni të shihet për 1-10 sekonda.


SNAPKIDZ

Si rrjetet sociale tjera ashtu dhe Snapchat lejon përdorimin e aplikacionit mbi moshën 13 vjeçare. Ata të cilët janë më të rinj se 13 vjeç atëherë Snapchat i drejton tek Snapkidz; version ky më i sigurt për fëmijë. Në Snapkidz fëmijët mund të bëjnë fotografi, video, dhe të vizatojnë; të gjitha këto ruhen vetëm në pajisjet e tyre. Ata nuk mund të bëjnë shokë askënd dhe t'i dërgojnë fotografi askujt. Me pak fjalë Snapkidz u mundëson fëmijëve të luajnë me fotografitë e tyre vetëm në pajisjet e tyre.



POSTIMI NË SNAPCHAT

Të rinjtë përdorin aplikacionin për t'u dërguar fotografi miqve se ku ndodhen, çfarë po bëjnë etj. Fotografitë mund t'u dërgohen miqve të caktuar mirëpo është dhe mundësia e postimit të fotografisë në "Story", me ç'rast mund ta shohin të gjithë miqtë e Snapchat-it. Këto fotografi qëndrojnë 24 orë dhe pastaj zhduken.





- Postimet tuaja në “My Story” ku mund t’i shohin miqtë të cilët i keni në Snapchat.
- Postimet e miqve tuaj (fotografi apo video).

OPSIONET E PRIVATËSISË

Tek parametrat e Snapchat, ju keni mundësi t’i bëni private fotografitë dhe videot të cilat i postoni kështu që vetëm miqtë e juaj mund t’i shohin. Poashtu, te opsioni se kush mund të ju dërgojë

fotografi e keni mundësinë t’i lejoni vetëm miqtë tuaj të ju shkruajnë dhe të ju dërgojnë fotografi dhe video.





- Nëse për çdo rast ndiheni të ngacmuar nga një person, ju mund të bllokoni atë duke mos i lejuar të ju gjejë më në Snapchat.
- Vetëm miqtë e juaj mund të ju dërgojnë fotografi apo video.
- Vetëm miqtë e juaj mund të shohin se çfarë keni postuar.

RREZIQET E SNAPCHAT

Edhe pse Snapchat është aplikacioni i parë i cili nuk i ruan fotografitë, videot, dhe bisedat në telefon prapë mund të sjellë rreziqe. Kur ju dërgoni një fotografi e cila mund të jetë më së shumti 10 sekonda, personi të cilit ia keni dërguar ka mundësi ta ruajë atë fotografi duke ia bërë "Screenshot".




Një rrezik tjetër i shfaqur kohëve të fundit është instalimi i aplikacioneve si "SnapSave",

“QuickSave” etj të cilët mundësojnë ruajtjen e të gjitha fotografive që dërgohen në Snap. Sapo ta instaloni ndonjërin prej këtyre aplikacioneve, ju keni mundësi t’i mbani në pajisjet e juaja të gjitha fotografitë që ua dërgojnë miqtë pa njohurinë e tyre.



Këshilla më e mirë për prindërit është të ulen dhe të bisedojnë me fëmijët e tyre.

- Pyetni se a e përdorin Snapchat dhe sa shokë kanë në këtë rrjet social.
- Njoftoni fëmijët për mënyrat e ndryshme që mund të ruhen fotografitë e tyre nga persona të ndryshëm.
- Këshilloni fëmijët që nuk duhet të postojnë fotografi të pahijshme pasi që me ndryshimin e shpejtë të teknologjisë, çdo postim i tyre mund të shpërndahet çdokund.
- Nëse dikush e ngacmon atëherë duhet t’i tregoni fëmijës suaj që mund ta bllokojnë atë person apo edhe ta raportojnë.




YOUTUBE


Ndonëse Youtube nuk është rrjet social, prapë se prapë luan një rol të madh në atë se si fëmijët shfrytëzojnë kohën online. YouTube është një uebfaqe e cila lejon shpërndarjen e videove të ndryshme, këngëve, filmave apo serialeve të shkurtëra, dhe shumë lloje të tjera të videove. Te butoni "search" fëmijët mund të kërkojnë video interesante edukative. Anash videos ju shfaqen video të tjera të cilat ju sugjerohen t'i shikojnë. Mirëpo, këto video jo gjithmonë janë të sigurta.

Në momentin që një fëmijë ka klikuar në një video në YouTube, ka gjasa t'i dalin shumë video të tjera të papërshtatshme. Fëmija nga kurioziteti klikon mbi to dhe ndonjëherë ndodh që pamja e një videoje duket ndryshe nga ajo se çfarë përmban e gjithë videoja. Për shembull, fëmijët janë duke shikuar një film vizatimor dhe anash saj dalin filma vizatimorë të tjerë të rekomanduar.


■ Kërkimi i videos

■ Videot e rekomanduara





■ Filma të
tjerë të
rekomanduar




Në njërin prej filmave të rekomanduar shihet fotografia e filmit "Hirushja" dhe fëmijët klikojnë për ta shikuar. Fatkeqësisht, kjo mund të jetë një video krejt ndryshe prej Hirushës me përmbajtje të papërshtatshme. Andaj, është shumë e rëndësishme që t'i shikoni videot paraprakisht. Me këtë rast, ju mund të raportoni video të papërshtatshme duke klikuar tek ikona "More" poshtë videos.

Pastaj, zgjedhni opsionin përse e raportoni këtë video: 1) përmbajtje seksuale, 2) përmbajtje të dhunës, 3) përmbajtje urryese, 4) akte të rrezikshme, 5) abuzim i fëmijëve, 6) spam ose me përmbajtje të rreme, 7) më cenon të drejtat.

POSTIMI I VIDEOVE NË YOUTUBE


Të gjithë e kanë mundësinë të postojnë në YouTube video nga më të ndryshmet. Fëmijët mund të postojnë shumë lehtë në YouTube. Për të

Edhe tek YouTube qëndron mundësia e privatizimit të videove të postuara. Në momentin e publikimit të videos, është mundësia e përzgjedhjes së privatësisë: publike - të gjithë mund të shohin videon, jo e listuar (unlisted) - video nuk del si



postuar në YouTube mjafton që të kenë një llogari të hapur. Publikimi i videove bëhet duke klikuar tek opsioni "Upload" dhe pastaj duke selektuar videon që dëshironi të publikohet.

rekomandim i listuar pa u kërkuar, private - askush nuk mund ta shohë videon përveç atyre që ju i lejoni.



KONKLUZIONE

Fëmijët përdorin rrjetet sociale si një ndër format më të popullarizuara për argëtim. Edhe pse rrjetet sociale janë një mjet i mirë dhe i shpejtë për komunikim dhe shpërndarje të informacioneve, rrjetet sociale gjithashtu ofrojnë shumë rreziqe për fëmijët. Në veçanti në rast se nuk mirren masat e duhura të privatësisë dhe nëse nuk punojhet për ngritjen e vetëdijësisimit. Masat e privatësisë ndryshojnë shumë shpesh, andaj është shumë e rëndësishme që t'i lexoni sa më shpesh ato dhe t'i përvetësoni. Disa nga rregullat e përgjithshme për prindër, kujdestarë dhe arsimtarë rreth rrjeteve sociale janë:

- Mos i lejoni fëmijët të hapin llogari në facebook nëse janë nën moshën 13 vjeçare. A e dini që askush nën moshën 13 vjeçare nuk është i lejuar të ketë llogari në Facebook? Prindi duhet të vendosë a t'i lejohej fëmijës të ketë një llogari apo jo.
- Gjithmonë jeni të informuar me kohë se çfarë po ndodh me teknologjinë dhe cilat janë ndryshimet që po ndodhin në rrjetet sociale. Mos ngurroni të pyesni fëmijët rreth më të rejave ngaqë ata janë shpeshherë më afër lajmit.
- Inkurajoni fëmijët që gjithmonë të mbajnë llogaritë private ngaqë kështu do të jenë më

mirë të mbrojtur nga keqpërdorimi i llogarive të tyre.

- Këshilloni fëmijët që të pranojnë si miq vetëm personat që i njohin dhe mos të komunikojnë me persona të panjohur.
- Mësoni fëmijët që pëlqimet dhe komentet në rrjetet sociale nuk janë edhe aq të rëndësishme dhe jo domosdoshmërisht do të thotë që personat që kanë më shumë pëlqime në rrjetet sociale janë më të popullarizuar.
- Rishikoni rrjetet sociale bashkë me fëmijën tuaj dhe komentoni rreth postimeve të ndryshme. Inkurajoni fëmijën tuaj që të ju dërgojë së pari juve postimet që dëshiron t'i postojë (fotografitë, videot) për miratim. Poashtu sigurohuni që përmbajtja e fotografive të jetë plotësisht e padëmshme për fëmijën tuaj dhe të mos identifikohet vendndodhja.
- Sugjeroni fëmijët që të përdorin sa më pak "check-ins" apo lokacionin se ku gjenden.
- Përdorni programe për filtrim – ka shumë programe të ndryshme përmes të cilave mund t'i monitoroni aktivitetet e fëmijëve online. Disa programe si PureSight PC dhe Net Nanny mundësojnë monitorimin e faqeve të rrjeteve sociale, bllokimin e bisedave, filtrimin

e përmbajtjeve, etj. Poashtu ka programe për monitorimin e telefonave celularë, si p.sh aplikacioni My Mobile Watchdog.

- Krijoni rregulla për përdorimin e internetit për fëmijën tuaj ashtu sikurse rregullat për botën reale. Kjo më së miri bëhet nëse në familje krijoni një kontratë me rregulla për përdorim të internetit, për të cilat do të bisedoni hapur me fëmijën dhe do të nënshkruhet nga të dy palët: prindërit dhe fëmija.
- Gjithmonë mos harroni të pyesni veten nëse ju jeni një shembull i mirë dhe duke treguar rregulla të mirësjelljes së duhur.
- Bëhuni shembull i mirë në përdorimin e rrjeteve sociale - gjithmonë pyesni veten se a jeni ju duke demonstruar sjelljen e duhur për përdorimin e drejtë të teknologjisë.

REFERENCA

Musmurati, Besianë, Zymeri, Teuta, *Siguria e fëmijëve në internet*, Save the Children, Prishtinë, 2014

McAfee, Inc., *A parent's guide to social networking sites*, Santa Clara, CA, 2009, web

<http://promos.mcafee.com/en-US/PDF/SocialNetworkinge-guide.pdf>

Public Legal Education & Information Center of New Brunswick, *Child Internet Safety*, New Brunswick, 2015, web

http://www.legal-info-legale.nb.ca/en/uploads/file/pdfs/Safety_on_the_Internet_Parents_Guide_EN.pdf

Company Info, Facebook Newsroom, Menlo Park CA, 2015, web

<http://newsroom.fb.com/company-info/>

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37:004(036)

Zymeri, Teuta

Rrjetët sociale : udhëzues i detajuar për prindër,
kujdestarë dhe arsimtar /Teuta Zymeri, Gresa
Statovci, Nertila Ahmeti. – Prishtinë:
Save the Children, 2015. – 34 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

Referencat : f. 34

1. Zymeri, Teuta 2. Statovci, Gresa 3. Ahmeti,
Nertila

ISBN 978-9951-534-36-9

Qendra për studime të avancuara FIT

Adresa: Rruga Eqrem Çabej, nr 166,
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

E-mail: info@fit-ks.org
www.fit-ks.org
www.internetisigurte.org



Qendra për studime të avancuara FIT
E-mail: info@fit-ks.org
www.fit-ks.org



Save the Children

ISBN 978-9951-534-36-9



9 789951 534369